NJOFTIM DREJTUAR HUAMARRËSIT HIPOTEKOR:

Nëse keni humbur të ardhura ose keni pasur rritje të kostove gjatë pandemisë së COVID-19 dhe nënshkruani dhe e dorëzoni këtë formular të deklaratës së vështirësisë tek huadhënësi juaj hipotekor, ose një agjenci tjetër sekuestruese, ju mund të jeni të mbrojtur nga sekuestrimi të paktën deri më 15 janar 2022. Nëse një padi për sekuestrim është ngritur ndaj jush dhe ia jepni këtë formular paditësit ose gjykatës, veprimi ligjor do të shtyhet deri më 15 janar 2022, përveç nëse paditësi vendos të kundërshtojë deklaratën tuaj të vështirësisë. Nëse gjykata e vendos si të vlefshëm pretendimin tuaj të vështirësive, veprimi i sekuestrimit do të shtyhet deri pas 15 janarit 2022. Ndërsa procedimi përmbarimor shtyhet, ju mund të mbeteni në posedim.

Nëse huadhënësi juaj hipotekor ose një agjenci tjetër sekuestruese ju ka dhënë këtë formular, huadhënësi hipotekor ose agjencia sekuestruese duhet gjithashtu t'ju sigurojë një adresë postare dhe email-i se ku ta ktheni këtë formular. Nëse tashmë jeni në proces gjyqësor mbi sekuestrimin, ju mund ta dërgoni këtë formular pranë gjykatës. Për informacionin tuaj, ju duhet të ruani një kopje ose foto të deklaratës suaj. Gjithsesi, ju do të duhet ta paguani borxhin për të gjithë shumën dhe tarifat ligjore që ju i detyroheni huadhënësit tuaj hipotekor. Ju gjithashtu duhet të ruani me kujdes të gjitha pagesat që keni bërë si dhe çdo shumë tjetër që nuk e keni paguar ende.

Ndihma financiare mund të jetë në dispozicion për ju edhe nëse më parë ju është refuzuar. Ju duhet të kontaktoni zyrën tuaj lokale të ndihmës për strehim për informacionin e aplikimit

.

Index Number (if known/applicable): _____

County and Court (if known/applicable): _____

DEKLARATA E HUAMARRËSIT HIPOTEKOR PËR VËSHTIRËSITË NË LIDHJE ME COVID-19

Unë jam huamarrësi hipotekor i pronës në (adresa e njësisë së vendbanimit):

_____

Përfshirë banesën time kryesore, unë zotëroj, drejtpërdrejt ose tërthorazi, dhjetë ose më pak njësi banimi. Unë jam duke hasur në vështirësi financiare dhe nuk jam në gjendje ta paguaj plotësisht kredinë time hipotekore, për shkak të një ose më shumë arsyeve të mëposhtme:

1. Humbje të konsiderueshme të të ardhurave për shkak të pandemisë së COVID-19.

2. Rritje të shpenzimeve të nevojshme nga xhepi në lidhje me kryerjen e një pune thelbësore ose me ndikimet shëndetësore gjatë pandemisë së COVID-19.

3. Përgjegjësitë ndaj kujdesit të fëmijëve ose një të moshuari, ndaj dikujt me aftësi të kufizuara ose një pjesëtari të sëmurë të familjes gjatë pandemisë së COVID-19 kanë ndikuar negativisht në aftësinë time ose aftësinë e dikujt në familjen time për të gjetur një punë të përshtatshme ose për të fituar të ardhura ose kanë rritur shpenzimet e mia të nevojshme nga xhepi.

4. Shpenzimet e zhvendosjes dhe vështirësitë që kam për të siguruar strehimin alternativ e bëjnë të vështirë që unë të zhvendosem në një banesë tjetër gjatë pandemisë së COVID-19.

5. Rrethana të tjera në lidhje me pandeminë e COVID-19 kanë ndikuar negativisht në aftësinë time për të gjetur një punë të përshtatshme ose për të fituar të ardhura ose i kanë ulur ndjeshëm të ardhurat e familjes sime ose i kanë rritur ndjeshëm shpenzimet e mia.

6. Një ose më shumë nga qiramarrësit e mi nuk e kanë paguar në kohë një shumë të konsiderueshme të qirasë së tyre që prej 1 marsit 2020.

Deri në masën që kam humbur të ardhurat familjare ose kam rritur shpenzimet, çdo asistencë sociale, përfshirë pagesën e përkohshme të papunësisë, atë të papunësisë për shkak të pandemisë, pagesës së aftësisë së kufizuar ose lejes familjare me pagesë, që kam marrë që nga fillimi i pandemisë së COVID-19 nuk e kompenson plotësisht humbjen time të të ardhurave familjare ose shpenzimet e shtesë.

Unë e kuptoj se duhet të veproj në përputhje me të gjitha kushtet e tjera ligjore sipas marrëveshjes së kredisë hipotekore. Unë e kuptoj më tej se tarifat e ligjshme, gjobat ose interesi për shkak të mospagesës së plotë të kredisë hipotekore siç kërkohet nga marrëveshja e kredisë, mund jenë të detyrueshme ose të mblidhen dhe mund të ndodhë që të lëshohet një urdhër gjykate për pagesë kundër meje. Unë e kuptoj më tej që huadhënësi im hipotekor, ose pala tjetër sekuestruese mund të kërkojë një seancë për të kundërshtuar certifikimin e vështirësisë së bërë këtu dhe se do të kem mundësinë të marr pjesë në çdo veprim ose procedim në lidhje me interesin tim hipotekor. Unë e kuptoj gjithashtu se kreditori im ose një agjenci tjetër përmbaruese mund të marrë veprime sekuestrimi ndaj meje më ose pas datës 15 janar 2022, nëse unë nuk e shlyej plotësisht ndonjë pagesë të prapambetur ose të pjesshme dhe tarifë ligjore.

Nënshkroi: _____

Emri i plotë me shkronja shtypi: _____

Data e nënshkrimit: _____

NJOFTIM: Ju po e nënshkruani dhe e dorëzoni këtë formular nën përgjegjësi ligjore penale. Kjo nënkupton se deklarimi i fakteve në këtë formular për të cilat jeni në dijeni se janë të rreme, përbën shkelje të ligjit.